



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501474/9

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandohet kryerja e veprimeve sa më parë të jetë e mundur për përmbushjen e detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor të formës, së prerë Nr11155, datë 19.11.2012, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, në favor të shtetases V.Z., etj.*

Drejtuar : **Erjona Rafti**
Regjistruese e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

KORÇË

Për dijani : **Ilirjan Muho**
Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Llambriola Misto
Sekretare e Përgjithshme
Pranë : Ministrisë së Drejtësisë

TIRANË

V.Z.
Adresa:

KORÇË

Znj. Rafti!

Në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetases V.Z., Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar organin që ju përfaqësoni, me shkresat nr.K2/I34-4 Prot, datë 04.09.2015, dhe nr.K2/I34-6 Prot, datë 09.09.2015, dhënien e shpjegimeve rreth shkaqeve të cilat justifikojnë mospërmbushjen deri më sot të detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor të formës, së prerë nr.11155, datë 19.11.2012, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, lënë në fuqi prej Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë me Vendimin nr.2421, datë 17.06.2014, për të cilin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr. 5583 Akti, datë 17.10.2014, me objekt:

“Detyrimin e të paditurit Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Korçë, të pajisë me certifikatë pronësie paditësen V.Z. për sipërfaqen 10.000m² e ndodhur në Qytetin e Korçës, që i përket parcelës nr.68, me kufizime : Veriu – M.S. dhe R..H, Jugu- Përrua, Lindja – Përrua dhe K.P, Perëndimi – S.A”.

Në përgjigje të kërkesave, ju me Tuajën Nr.5617/1 prot, datë 21.09.2015, shpreheni se keni zhvilluar korespondencë me ZQRPP, Tiranë, për çështjen e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor, për shkak të pamundësisë së ekzekutimit të tij nga ana juaj.

Referuar informacionit të dhënë nga ana juaj, rezulton se, shkak për mosekzekutimin e Vendimit Gjyqësor të formës, së prerë nr.11155, datë 19.11.2012, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, është pamundësia e pozicionimit të pasurisë së ankueses në HRT e ZVRPP, Korçë, si dhe mosregjistrimi i saj në një kartel, etj.

Pretendimet e ngritura prej organit që ju përfaqësoni, për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur sipas vendimit gjyqësor të lartpërmendur, nuk kanë përbërë dhe nuk përbëjnë shkak për mosekzekutimin e tij, përkundrazi, qëndrimi i shprehur nga ana juaj, në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 606 të K.Pr.C. përbën shkak për vendosjen e sanksioneve ligjore nga ana e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor.

Pasuria në bashkëpronësi e ankueses, referuar akteve të vëna në dispozicion nga ana juaj, rezulton e rregjistruar në emër të trashëgimtarëve të M.Z.. në rregjistrin hipotekor me nr. 114/17, datë 01.10.1999. Përkundër pretendimeve të lartpërmendura, për pamundësinë e ekzekutimit të detyrimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, me të drejtë në Vendimin nr.11155, datë 19.11.2012, ka arsyetuar se :

“Pra ndodhur në këto kushte (rregjistrimit të pasurisë në rregjistrin hipotekor me nr.114/17, datë 24.06.1999) të gjitha pretendimet e përfaqësuesve të të paditurit në gjykim por edhe në aktet administrative, object gjykimi, janë të pabazuara pasi në fakt vendimi figuron i rregjistruar në rregjistrin hipotekor nr.114/17, datë 24.06.1999, dhe veç sa sipër pronarët kanë marrë prej të paditurit edhe vërtetim nga dokumente hipotekore për këtë sipërfaqe, ç’ka do të thotë që përderisa figuron e regjistruar janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore të formalizuara në Ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar”.

Gjithashtu, referuar pjesës arsyetuese të Vendimit Gjyqësor të formës, së prerë nr.11155, datë 19.11.2012, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, konstatohet se, ZVRPP, Korçë, me rastin e rregjistrimit të pjesës takuese për çdonjerin prej trashëgimtarëve të të ndjerit Mihal Zavalani, ka mundur me anë të punonjësve të saj, mbajtjen e procesverbalit datë 22.06.1999, për vënien në posedim të sipërfaqes prej 10.000m² trashëgimtarëve të M.Z.

Në këto kushte, qëndrimi që mbahet nga ana e organit që ju përfaqësoni, për çështjen në fjalë, është në shkelje të së drejtës të pronës private, të mbrojtur sipas sanksionimit të kryer në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të mbrojtur sipas sanksionimit të kryer në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, në referim të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, i cili sanksionon se : *“Organet e shtetit janë të detyruar të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*, nenit 451/a të K.Pr.C, se : *“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera...”*, si dhe faktit që Gjykata e Lartë nuk ka vendosur deri më sot, për pezullimin e ekzekutimit të 11155, datë 19.11.2012, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, gjykojmë se, qëndrimi juaj është në shkelje të së drejtës të pronës private, cënim të

parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenet 41, dhe 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor në fjalë, si dhe parimeve të ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtave të personave private, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjshmërisë, mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e Organeve të Administratës Publike, të sanksionuara në nenin 9, 10, 12, 14 të K.Pr.A., dhe të detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Vlerësojmë se, në mënyrë të pajustificuar e në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në nenin 9 të K.Pr.A. nuk është bërë e mundur deri më sot, ekzekutimi i detyrimit të vendosur nga gjykata..

Mospërmbushja prej më shumë se 1 viti i detyrimit për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të gjyqfituesit, sikurse vendosur me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë Nr.11155, datë 19.11.2012, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, lënë në fuqi prej Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, me Vendimin Nr.2421, datë 17.06.2014, me pretendime të cilat nuk janë marrë në konsiderat nga gjykata në procesin e shqyrtimit të padisë së ngritur prej ankuesit, përbën shkak për ankuesin, t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkeljen e së drejtës së pronësisë si dhe cënim të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të garantuara sipas nenit 41, 42/2 të Kushtetutës apo neni 6/1 i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, miratuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, *“Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”*.

Ekzekutimi i titujve ekzekutiv brenda një afati të arsyeshëm është tashmë një standart i konsoliduar nga Gjykata Kushtetuese si dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjykata ka theksuar se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Nga këndvështrimi i parimeve kushtetuese, lidhur me procesin e rregullt ligjor, që burojnë nga nenet 42 dhe 142/3 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të vet nocionit të gjykimit të drejtë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të prekë thelbin e së drejtës.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëj rekomandime dhe të propozoj masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit të vendosur sikurse përcaktuar në dispozitivin e Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.11155, datë 19.11.2012, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, në favor të trashëgimtarëve të M.Z.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI

Konceptoi dhe Daktiligrafoi
A.Gjoleka